



273 31.05.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 40/2017
Datë: 22.05.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i Projektit/kërkesës për renovimin e kulmit dhe suvatimin e shtëpisë në ngastrën kadastrale Nr. 3255 – 0 Z.K. Prizren”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetimi

Kjo kërkesë, e palës Muharem dhe Menduh Bamija nga Prizreni, është drejtuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor e Komunës së Prizrenit në QRTK-Prizren, më 27.04.2017 dhe pastaj më datë 28.04.2017 është pranuar dhe protokoluar në IKMM, me nr.protokoli 196/2017.

Muharem dhe Menduh Bamija nga Prizreni kanë parashtruar kërkesë për renovimin e kulmit dhe suvatimin e shtëpisë, në ngastrën kadastrale me nr.3255-0, në rrugën "Hysen Rexhepi". Objekti gjendet në zonën e VIII-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit, ku etazhiteti i lejuar është P+2 (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet deri 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku kërkohet të bëhet renovimi i shtëpisë, gjenden objektet si Xhamia e Ilijaz Kukës, Xhamia e Myderriz Ali Efendisë dhe Kompleksi i Kishës Katolike që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrotjtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017).

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës si dhe të projektit ideor aprovon projektin, i cili është në përputhshmëri me parametrat e caktuara me Plan të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Të aprovohet kërkesa për renovimin e kulmit dhe suvatimin e shtëpisë, në ngastrën kadastrale me Nr.3255-0, projekti i të cilit përmbush kriteret për renovim në zonën e VIII-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit.
2. Ngjyra e ndërtesës të përcaktohet në bazë të Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit në bashkëpunim me QRTK Prizren.
3. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM-në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri
U.D. Drejtor

